



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 23.11.2018

Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Luan Dervishi.</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z. Luan Dervishi</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor.</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor që ajo të shtyhej për shqyrtim të mëtejshëm.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Në fund të seancës dëgjimore trupi gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën për shpalljen e tij në datën 26.11.2018, ora 11:30.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Tupa gjykyese (emrat)	<i>Kryesues: Firdes Shuli, Relator: Etleda Ciftja, Anëtar: Pamela Qirko</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN): zj. Mia Raising.</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Ardian Visha (Avokat)</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Amilda Celami</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u lejuan media, qytetarë të rastësishëm, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, si dhe kushdo që mund të ishte i interesuar. Numri total i të pranishmëve varioonte 15-20 persona.</i>
Media e pranishme:	<i>Gazetarë dhe operatorë të mediave të ndryshme ishin të pranishëm.</i>

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vetingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	<i>Po/Jo</i>	<i>Procesi i rivlerësimit kalimtar është bazuar mbi tre kriteret.</i>	

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Raporti i ILDKPKI-së pasqyron: 1) Truall 365m2, 2)Ndërtimi i Ap. 125m2 në trullin e mësipërm dhe garazh, 3).Automjet Ford Focus, vlera 13.900 euro, 4) Aksionet e bonove të privatizimit nga bashkëshortja 125 mijë lekë.4. Toyota vlera 64.000 USD	Raporti nga ILDKPKI	Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës, aftësive profesionale, relatori i çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në të dhënat e ardhura nga ILDKPKI, DSIK, raporti nga Inspektoriati I KLD,hetimi administrativ I KPK së, të dhënat të marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.
	Nga hetimi i thelluar i KPK-së: Lidhur me truallin 365m2, në bashkëpronësi më të tjerë, burimi: kontratë dhurimi e vitit 1998, KPK ka gjetur mospërputhje në deklaratën e vitit 2017, ku subjekti e ka parashikuar si dhurim dhe në deklaratën e vitit 2003 konfiguroni e blerë 2400 USD. Subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumenta kontratën e dhurimit. Lidhur me pasurinë nr. 2, apartamenti 125m2, ka mospërputhje për burimin e krijimit. Në deklaratën e vitit 2017 rezultoni si burim i krijimit kredi dhe të ardhurat nga puna e subjektit ndërsa në deklaratën e vitit 2003 si burim të ardhurash subjekti ka cilësuar të ardhurat nga puna si avokat, shitja e shtëpisë dhe zyrës në Librazhd. Apartamenti rezultoni të jetë shitur, në kontratën e shitjes, palë është shoqëria "D"ndërsa derdhja e parave në bankë është bërë nga një tjetër shoqëri. Subjekti nuk ka paraqitur dokument lidhur me shumën 42 000 lekë si rrjedhojë e shitjes së shtëpisë dhe zyrës në Librazhd. S'ka dokumenta justifikues për punën si avokat. Nga hetimi i KPK-së rezultoni se subjekti ka në pronësi 3 garazhe, për të cilat ka mospërputhje për nr, sipërfaqen dhe mënyrën e përfitimeve. Lidhur me pasurinë nr 3, rezultoni si burim për blerjen e tij, të ardhura nga puna e subjektit, bashkëshortes së tij dhe nga kontributi i të birit që jeton në SHBA. KPK vëren se ka mospërputhje mbi mënyrën e pagesës dhe datat e shlyerjes. Lidhur me automjetin Toyota, ska të dhëna për të ardhurat e djalit. 15.000 \$ rezultojnë të paprovuara të cilat kanë shërbyer për shkollimin e së bijës.	Relatori i çështjes	
		Mbrojtja	
	Ka një mungesë të dokumentacionit mbi të ardhurat nga puna pasi tatimi mbi të ardhurat ka filluar të bëhet në vitin 1998. Nuk ka vërtetim për pagën. Nga viti 2003 deri në vitin 2016 ka blerë vetëm një makinë. Analiza financiare që ka bërë KPK, sipas subjektit rezultoni pozitive. Në vitet 2013-2014 vërtetoni se ka jetuar tek shtëpia e vjehrrës. Në vitin 2009 ka rritur garancinë në bankë për shkak të studimeve të së bijës në SHBA.	Subjekti	
		Ankesa nga publiku ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Raporti i DSIK rekomandon për subjektin e rivlerësimit : Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.	Të dhëna nga raportet e DSIK	
	Relatori i çështjes pohoi se lidhur me figurën e z.Dervishi ka pasur denoncime për korrupsion, kontakte me krimin e organizuar dhe përfshirje në veprimtari të kundraligjshme.	Relatori	
	DSIK ka bërë një vlerësim tërësisht subjektiv. Mbrojtje kërkoj të bëhet i ditur emri i personit (Krimi organizuar) më të cilin z.Dervishi ka pasur kontakte. Çështjet që i janë nënshtruar hetimit të KPK-së janë jashtë çështjeve që sipas rregullit duhet të jenë pjesë e hetimit dhe rezultojnë të preferuara qartë nga KPK.	Mbrojtja	
		Subjekti	

	13 ankesa	Ankesa nga publiku	
		ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Raporti i KLD-së e ka cilësuar subjektin: Me ftësi të mira në arsyetimin e ligjit. Lidhur me aftësitë organizative cilësohet eficient dhe efektiv. Karakterizohet nga paanësia në gjykimet e tij. Pranë KLD-së janë paraqitur 9 ankesa për vitet 2013-2018.	Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	
	Relatorja e çështjes shpjegoi analizimin e vendimeve gjyqësore të kryesuara nga subjekti i rivlerësimit. Vendimi lidhur me çështjen "Mjacaj", e cilësuar si një çështje meditative, për të cilat nuk ishin respektuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Për 3 vendime të tjera (kryesues z.Dervishi) rezultoi të ishte ndryshuar ciësimin juridik veprave penale.	Relatori	
		Mbrojtja	
	z.Dervishi e cilësoi vendimin e dhënë ndaj "Mjacaj" të rregullt në respektim të ligjit. Ai trajtoi 3 vendimet e tjera të cilat ishin analizuar nga KPK duke u shprehur se kishte ndryshuar mënyrën e vuajtjes së denimit dhe jo cilësimin juridik të veprave.	Subjekti	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z.Luan Dervishin gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Shkodër u paraqit e rregullt në tërësi, duke respektuar kriteret për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjatë gjykimit të seancës dëgjimore u trajtuan të tre kriteret e procesit të rivlerësimit. Subjekti pohoi se ishte njohur me dosjen dhe i ishte kaluar barra e provës, të cilën e kishte shfrytëzuar. Trupi gjykues në asnjë moment nuk shkeli rregullat e etikës, profesionalizmit. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të përfaqësohej nga një mbrojtës ligjor. Gjatë zhvillimit të seancë dëgjimore u konstatua një numër I konsiderueshëm ankesash në drejtim të subjektit, për të cilat relatori i çështjes tregoi vetëm natyrën e tyre duke mos përfshirë detaje lidhur me to. Denoncimet kishin karakter korruptiv, lidhje me krimin e organizuar dhe përfshirje në veprimtari të kundërligjshme. Mbrojtësi ligjor në fjalën e tij kërkoi të bëheshin të ditur nga ana e trupës gjykues identitetet e personave me të cilët subjekti i rivlerësimit kishte pasur kontakte të papërshtatshme. Kjo kërkesë nuk gjeti mbështetjeje e trupit gjykues. Në seancën dëgjimore u lejuan të ishin pjesëmarrës, përfaqësues të mediave, të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit si dhe kushdo që ishte i interesuar. Përmasat e sallës ovale në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve) garantonte respektimin e plotë të standardeve të një seance publike.		